



**Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina**

Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 04/L -144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), të nenit 20 të Rregullores së QRK-së, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2018, merr këtë

**V E N D I M**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01.NR.031-137672, TË DT. 29.06.2015, PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË OBJEKTIT TË ISH-KONVIKTIT TË NXËNËSVE TË SHML "GJIN GAZULLI" NË PRISHTINË, UNIVERSITETIT AMERIKAN NË KOSOVË**

**I.**

MIRATOHET Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01. nr. 031-137672, të dt. 29.06.2015, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të objektit të ish-Konviktit të nxënësve të SHML "Gjin Gazulli", në Prishtinë, Universitetit Amerikan në Kosovë.

**II.**

Sipas vendimit të cekur në pikën I, plotësim ndryshimi nënkupton:

1. Ndryshohet pika III e vendimit, ku dhënia në shfrytëzim e objektit nga periudha kohore afatshkurtër prej (10) vjetësh, zgjatet në periudhën kohore afatgjatë prej pesëdhjetë (50) vjet.

**III.**

Vendimi për plotësim-ndryshim e Vendimit 01.nr.031-137672, të dt. 29.06.2015, të cekur në pikën II, është bërë që objekti të shfrytëzohet për investime që mundësojnë rritjen e fushëveprimit akademik dhe investimet tjera në kampus.

**IV**

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS  
01-353/01-0263818/18, më 01.11.2018**

**KRYESUESI I KUVENDIT  
Agim Kuleta**

